



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE



RAPORTI RREGULLATIV

**Vlerësimet Preliminare për Përcaktimin e të Hyrave të Lejuara për Ngrohtoren e Qytetit
Termokos SH.A. – Sezoni i Ngrohjes 2016/2017**

/Draft për konsultim publik/

Prishtinë, shtator 2016



PËRMBAJTJA

Faqe

1.	Hyrje.....	3
2.	Parimet dhe Formulimi i Metodologjisë Tarifore	4
3.	Përcaktimi i të Hyrave të Lejuara.....	6
3.1	Vlerësimi dhe përcaktimi i kostove operative të lejuara.....	8
3.2	Përcaktimi i Bazës së Rregulluar të Aseteve (RAB).....	15
3.2.1	Përcaktimi i Aseteve Ekzistuese	15
3.2.2	Përcaktimi i Investimeve të reja të lejuara.....	18
3.2.3	Përcaktimi i Kapitalit Punues	19
3.2.4	Tjetërsimet	19
3.3	Vlerësimi dhe Përcaktimi i Zhvlerësimit Vjetor	20
3.4	Përcaktimi i Kthimit të Lejuar në RAB (Fitimi i Lejuar)	20
3.4.1	Llogaritja e Normës së Kthimit (RoR) të Lejuar	21
3.5	Përcaktimi i Kostos së Humbjeve në Rrjet.....	24
3.6	Përshtatja (Axxhustimi).....	24
3.7	Llogaritja e të Hyrave të Lejuara - Përmbledhje.....	25

PËRMBAJTJA (vazhdim)

Figura 1: Skema e llogaritjes së të hyrave të lejuara	5
Figura 2: Paraqitja skematike e kostove kryesore (në €) të propozuara nga NQ Termokos dhe të pranuar (lejuara) nga ZRRE-ja për sezonin e ngrohjes 2016/2017.....	9
Figura 3: Paraqitja skematike e kostove operacionale të propozuara nga NQ Termokos dhe të lejuara nga ZRRE-ja për sezonin e ngrohjes 2016/2017	14
Tabela 1: Kostot e paraqitura nga ana e NQ Termokos SH.A., dhe ato të lejuara nga ZRRE (Në €)	8
Tabela 2: Kategorizimi i Aseteve ekzistuese pa asetet e projektit të kogjenerimit me vlerat përkatëse	16
Tabela 3: Kategorizimi i Aseteve të projektit të kogjenerimit me vlerat përkatëse	17
Tabela 4: RAB dhe komponentët e tij - NQ TERMOKOS sezoni i ngrohjes 2016/2017	19
Tabela 5: RAB _f dhe komponentët e tij - NQ TERMOKOS sezoni i ngrohjes 2016/2017	20
Tabela 6: Kthimi i Lejuar (Profiti i Lejuar) në RAB _f për NQ TERMOKOS për sezonin e ngrohjes 2016-2017.....	24



1. Hyrje

Në pajtim me legjislacionin primar – nenet 47 dhe 48 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) është përgjegjëse për përcaktimin e metodologjisë së tarifave dhe aprovimin e tarifave në sektorin e rregulluar të energjisë; këtu janë një sërë parimesh të gjera, siç janë parimet e mos-diskriminimit dhe arsyeshmërisë me të cilat ndërmarrjet e energjisë do të mund t'i rikthenin të gjitha kostot e arsyeshme përfshirë edhe kthimin e arsyeshëm në investimet e tyre. Gjithashtu nenet 18 dhe 19 të Ligjit për Energjinë Termike përcaktojnë se Furnizuesi me obligimin e shërbimit publik, kryen furnizimin me energji termike me tarifa të rregulluara.

Përderisa sektori i energjisë termike në transportimin dhe shpërndarjen e energjisë termike klasifikohet si monopol i natyrshëm, dhe për arsye se gjithashtu në gjenerim dhe furnizim ende nuk ekziston konkurrenca, atëherë tarifat e ngrohjes qendrore, që i përmbajnë të gjitha komponentët e lartpërmendura, i nënshtrohen përcaktimit - miratimit nga ZRRE-ja.

Brenda kompetencave dhe obligimeve të veta ligjore, Zyra e Rregullatorit për Energji ka nxjerrë Rregullën për Vendosjen e Çmimeve të Energjisë Termike. Rregulla përcakton procedurat për dorëzimin, shqyrtimin e aplikacionit tarifor dhe aprovimin e tarifave, si dhe Metodologjinë për llogaritjen e të hyrave të lejuara dhe tarifave.

Për përcaktimin e të hyrave të lejuara për sezonin e ngrohjes 2016/2017 janë marrë parasysh si vijon:

- Informatat e dhëna nga NQ Termokosi në aplikacionin e tyre tarifor për sezonin e ngrohjes 2016/2017;
- Informatat e dhëna nga NQ Termokosi gjatë raportimit rregullativ – shpenzimet dhe të ardhurat, asetet / investimet, si dhe informatat teknike dhe për konsumatorë që aktualisht janë realizuar në sezonin e ngrohjes 2015/2016 dhe në sezonet e mëparshme;

Ecuria e procesit të shqyrtimit tarifor:

- **Me 1 korrik 2016** – ZRRE ka lëshuar shkresën për njohtimin e fillimit të shqyrtimit të tarifave për NQ Termokos për sezonin 2016/2017;
- **Me 4 korrik 2016** – ZRRE përmes e-mailit i ka dërguar NQ Termokos kërkesën për të dhëna dhe informata, ku janë përshkruar detajisht të dhënat dhe informatat që NQ Termokos duhet dorëzuar për shqyrtimin tarifor, si dhe Planin dhe Orarin;
- **Me 25 korrik 2016** – NQ Termokos përmes e-mailit ka dorëzuar të dhënat dhe informatat për shqyrtim tarifor;
- **Me 29 korrik 2016** – Takim mes ZRRE-NQ Termokos - temat e takimit: i) njohtim me Rregullën për Vendosjen e Çmimeve të Energjisë Termike në veçanti shpjegime rreth Metodologjisë tarifore; ii) diskutim për procesin e shqyrtimit tarifor; dhe iii) diskutim dhe shpjegime për të dhënat dhe informatat e dorëzuara;
- **Me 17 gusht 2016** – Pas analizimit dhe vlerësimit të të dhënave dhe informatave të dorëzuara nga NQ Termokos, ZRRE ka dërguar komentet me shkrim, ku janë specifikuar kërkesat për korrigjim, përmirësim dhe plotësim të aplikacionit fillestarë;
- **Me 30 gusht 2016** – NQ Termokos ka ridorëzuar aplikacionin me disa nga korrigjimet, përmirësimet dhe plotësimet e kë kërkuara në komentet e ZRRE-së.



2. Parimet dhe Formulimi i Metodologjisë Tarifore

Për përcaktimin e të Hyrave të lejuara dhe të tarifave të energjisë termike për sezonin 2016/2017 është zbatuar Metodologjia e përcaktuar në Rregullën për Vendorsjen e Çmimeve të Energjisë Termike.

Parimet

Parim bazë i kësaj metodologjie është se tarifat për ndërmarrjet që ofrojnë shërbime publike duhet të mbulojnë të gjitha kostot - operative dhe kapitale, kështu që në një rën anë konsumatorët nuk do të duhej të paguajnë më tepër se sa kostoja e shkaktuar për ofrimin e shërbimeve, ndërsa në anën tjetër ndërmarrja e shërbimeve publike duhet të mbulojë të gjitha kostot e arsyetuara plus një normë të arsyeshme të kthimit në investimet kapitale. Çmimi final i shërbimit zakonisht përcaktohet për të përfshirë të gjitha kostot operative të ndërmarrjeve që ofrojnë shërbime publike, dmth., të mbulojë koston e prodhimit, shpërndarjes dhe furnizimit (operimi dhe mirëmbajtja, lënda djegëse, pagat, shpenzimet e përbashkëta, tatimet, etj.) plus një kthim të arsyeshëm në investimet që janë dedikuar ofrimit të shërbimit publik.

Duke qenë se në disa raste rregullimi i tillë nuk nxit ndërmarrjet për të ngritur efikasitetin operativ dhe të stimuloj kursimin e shpenzimeve, përkundrazi mund të nxisin mbi-investime në asete dhe gjithashtu, dhe duke marrë parasysh obligimin e Rregullatorit për të mbrojtur konsumatorët, kërkohet që ndërmarrjet jo vetëm të dëshmojnë “shpenzimet e arsyeshme” të deklaruara, por edhe të tregojnë një rritje të efikasitetit operativ dhe efikasitet në blerje. Masat e tilla krijojnë bazë për bashkërendimin në fillim të shqyrtimit tarifor, në të cilën Rregullatori shpërblen apo ndëshkon ndërmarrjen për rritjen apo rënien e efikasitetit dhe kontrollit të koston.

Formulimi

Me qëllim të llogaritjes së të Hyrave të lejuara dhe llogaritjes përfundimtare të tarifave, në Rregullën për Vendorsjen e Çmimeve të Energjisë Termike (shtojcat 1,2,3, dhe 6) është dhënë në detaje formulimi i Metodologjisë tarifore. Megjithatë, për arsye konsistence, formulimi do të paraqitet shkurtimisht edhe në këtë raport.

Skematikisht, Metodologjia tarifore mund të tregohet si më poshtë. Kostot të cilat ndërmarrja duhet t'i mbulojë përbëhen nga kostot operative, nga zhvlerësimi që paraqet mundësinë që ndërmarrja të zëvendësoj asetet e veta, koston e humbjeve të rrejtit dhe kthimin në Bazën e Rregulluar të Aseteve (RAB), e cila në fakt paraqet fitimin për ndërmarrjen.




Figura 1: Skema e llogaritjes së të hyrave të lejuara

Formulat bazë të rregullimit:

Të hyrat e lejuara janë llogaritur sipas formulës:

$$\mathbf{MAR = OPM + DEP + RTN + LOS + ADJ}$$

Ku:

- MAR** Të Hyrat e lejuara maksimale;
- OPM** Kostot e lejuara të operimit dhe mirëmbajtjes;
- DEP** Zhvlerësimi vjetor i lejuar;
- RTN** Kthimi i lejuar në asete;
- LOS** Kostoja e humbjeve në rrjet;
- ADJ** Përshtatja (axhustimi) i të hyrave.

Të Hyrat e lejuara paraqesin koston vjetore të kompanisë, e që përmbajnë: i) koston operative, të cilat janë të “arsyetuara”; ii) zhvlerësimin vjetor; iii) Koston e humbjeve në rrjet; dhe iv) kthimin e lejuar në Bazën e Rregulluar të Aseteve (RAB).

Kostot operative përbehen nga pjesa fikse dhe ajo variabile, e formuluar si vijon:

$$\mathbf{OC = OC_f + OC_v}$$

Kostot operative paraqesin koston totale të arsyetuara të parashikuara për një vit, e që këtu hyjnë: i) koston për lëndë djegëse, koston e blerjes së energjisë termike dhe koston tjera si energjia elektrike, kemikalet për trajtimin e ujit, pjesët rezervë; ii) koston tjera operative të sistemit, riparimet dhe mirëmbajtja; dhe iii) koston e personelit dhe koston e përbashkëta. Kostot operative të lejuara nuk përfshijnë: i) subvencionet; ii) koston e refuzuara nga autoritetet tatimore, dhe koston e ndarjes së rezervave apo shpërndarjes së tyre; dhe iii) pagesat e qirasë për mjetet që nuk janë të shënuara në llogarimbajtjen, shpenzimet financiare apo shpenzimet tjera të pa arsyetuara.



Baza e Rregulluar e Aseteve është llogaritur sipas formulës:

$$RAB_n^{end} = RAB_n^{start} + INV_n - DIS_{n-1} - DEP_{n-1} + WC_n$$

Duke qenë se në këtë sezon zhvillohet procesi i shqyrtimit tarifor pas një periudhe 4 vjeqare, ku ka pasur ndryshime të dukshme në strukturën dhe vlerën e asetëve, kryesisht për shkak të projektit të kogjenerimit, atëherë konsiderohet se përcaktohet RAB-i fillestar dhe formula e lartë-përshkruar modifikohet si më poshtë:

RAB = Vlera kontabël e Aseteve Ekzistuese (pas Zhvlerësimit të akumuluar) + Investimet e reja + Kapitali Punues – DIS (Tjetërsimet).

Baza e Rregulluar e Aseteve (RAB) paraqet asetet e ndërmarrjes të konsideruara për përdorim dhe të dobishme për ofrimin e shërbimit publik, e të cilat përfshijnë: i) vlerën e asetëve sipas librave kontabël (pas zhvlerësimit) ose vlerën fillestare të asetëve sipas librave kontabël minus zhvlerësimi i akumuluar; ii) investimet e reja kur janë të planifikuara dhe të aprovuara nga rregullatori; dhe iii) kapitali i mjaftueshëm punues për kompaninë që të kryejë aktivitetet e saj; dhe iv) Asetet e tjetërsuara.

ZRRE-ja, si Normë të Kthimit, ka marrë vlerën e WACC-ut (Kostoja e mesatares së ponderuar të kapitalit). WACC (%) është shuma e mesatares së ponderuar të kostos së ekuitetit dhe kostos së borxhit, dhe është llogaritur sipas formulës:

$$WACC = [(D/V) * k_d] + [(E/V) * k_e]$$

Ku:

D/V-	Pjesa e borxhit nga baza totale e kapitalit
E/V -	Pjesa e ekuitetit nga baza totale e kapitalit
V -	Baza totale e kapitalit, e cila është i gjithë ekuiteti dhe borxhi
k_d -	Kostoja e borxhit
k_e -	Kostoja e Ekuitetit

3. Përcaktimi i të Hyrave të Lejuara

Për përcaktimin e të Hyrave të lejuara të NQ Termokos-it SH.A. për sezonin 2016/2017, në pajtim Rregullën për Vendosjen e Çmimeve të Energjisë Termike, ZRRE ka ndërmarrë si vijon:

- 1) Vlerësimin dhe përcaktimin e kostove operative të lejuara;
- 2) Vlerësimin dhe përcaktimin e zhvlerësimit;
- 3) Përcaktimin e Kthimit të lejuar në RAB (fitimi i lejuar për kompaninë), i cili përfshin:
 - a) përcaktimin e RAB-it – vlerësimi dhe aprovimi i asetëve të kompanisë, verifikimi dhe aprovimi i investimeve të planifikuara dhe kapitalit punues; dhe
 - b) llogaritjen e Normës së kthimit të lejuar (RoR)/ WACC;
- 4) Vlerësimin dhe përcaktimin e kostos së lejuar për humbjet në rrjet.

Në përcaktimin e të Hyrave të lejuara, ZRRE ka marrë parasysh sa vijon:



- Informatat e ofruara nga NQ Termokosi në aplikacionin e tyre për tarifën për sezonin e ngrohjes 2016/2017 – informatën rreth të ardhurave të parashikuara nga shitja e ngrohjes dhe nga shërbimet e tjera të ndërlidhura, kostot e parashikuara totale, asetet dhe investimet e planifikuara, prodhimin dhe furnizimin e parashikuar të ngrohjes, si dhe sipërfaqen ngrohëse të parashikuar;
- Informatat e ofruara nga NQ Termokosi gjatë raportimit rregullativ – shpenzimet dhe të ardhurat, asetet/ investimet, si edhe informatat teknike dhe për konsumatorë të cilat faktikisht janë realizuar në sezonin e kaluar 2015/2016;
- Informatat që ZRRE i ka siguruar nga shqyrtimet tarifore dhe monitorimet e realizimeve dhe performancës të sezonave / viteve të kaluara.

Duke e ditur se informatat e parashikuara janë thelbësore për përcaktimin e të Hyrave të lejuara, këto do të duhej të ishin të besueshme dhe reale. Përgjithësisht, në parashikimin / planifikimin e biznesit do të duhej të kemi qasje reale të përcjellur me vlerësim të hollësishëm të faktorëve të shumtë që ndikojnë në biznesin; p.sh., vlerësimi i tregut dhe parashikimi i zgjerimit të bazës së konsumatorëve, vlerësimi i prodhimit / mundësitë e furnizimit dhe mundësitë financiare të kompanisë. Natyrisht, parashikimi/planifikimi i drejtë duhet të bazohet në të dhënat që kompania i ka realizuar në të kaluarën gjatë një periudhe të caktuar.

Duhet cekur këtu se, aplikacioni për tarifa i NQ Termokos gjer në një masë ka qenë i detajuar dhe i kompletuar. Megjithatë, në disa nga të dhënat dhe informatat që ka përmbajtur aplikacioni janë vërejtur pasaktësi, mos-përputhje dhe jo-konsistencë. Kjo ka ndodhur përkundër ndërhyrjes së ZRRE-së gjatë takimeve të rregullta dhe komenteve të shkruara, ku është insistuar për të dhëna dhe informata të sakta dhe konsistente. Por, megjithëkëtë për disa nga pozicionet kryesore informatat dhe të dhënat e pranuar kanë qenë jo-plotësisht të sakta dhe të pa mbështetura me dokumentacion përkatës, që ka shkaktuar vështirësi shtesë në vlerësim të aplikacionit.

Në fakt, sa i përket informatave të parashikuara (siç është përcaktuar në Shtojcën 4 të Rregullës për Vendosjen e Çmimeve të Energjisë Termike, NQ Termokosi i ka dorëzuar ZRRE-së pasqyrat/tabelat që përshijnë të ardhurat dhe kostot e parashikuara, të dhëna teknike dhe të konsumatorëve, asetet operative dhe investimet e parashikuara, për periudhën një vjeçare që mbulon plotësisht sezonin e ngrohjes: 15 tetor 2016 – 14 tetor 2017. Ndërsa si dokumente mbështetëse ka dorëzuar: i) Raportin e auditorit dhe Pasqyrat financiare statusore për vitin 2015; ii) Listën e nënstacioneve - të dhënat për sipërfaqet ngrohëse dhe kapacitetet përkatëse, si dhe të dhënat tjera teknike; iii) Listën e asetëve – të dhënat detale për asetet fikse ku janë dhënë vlera fillestare (e blerjes), zhvlerësimi i akumuluar dhe vlera e tanishme e asetëve (e dorëzuar në raportimet e rregullta vjetore/sezonale); iv) Planifikimet për kyçjet e reja për sezonin 2016/2017; v) Matjet e regjistruara për energjinë termike të prodhuar nga kogjenerimi (dorëzuar në raportimet e rregullta vjetore/sezonale; dhe vi) Të dhëna për faturimin e konsumatorëve bazuar në matjen e konsumit në sezonin e kaluar 2015/2016.

Pavarësisht nga sa u tha më lartë, ZRRE-ja ka bërë përpjekje dhe ka angazhuar ekspertizën në dispozicion për të bërë një vlerësim sa më real të informatave të parashikuara të dorëzuara nga ana e Termokosit. Është bërë një analizë gjithëpërfshirëse dhe vlerësim i informatave të paraqitura, që është përcjellur me krahasimin e të dhënave respektive nga sezonet e kaluara, me qëllim që të bëhet përcaktimi (parashikimi) i saktë i të hyrave të lejuara për sezonin 2016/2017.



3.1 Vlerësimi dhe përcaktimi i kostove operative të lejuara

Planifikimet për kostot operative të dorëzuara nga ana e NQ Termokosi për periudhën 15 tetor 2016 – 14 tetor 2017, periudhë kjo që mbulon gjithë sezonin e ngrohjes qendrore 2016/2017, janë strukturuar si kosto variabël dhe fikse, e cila ndarje kryesisht është në pajtim me dispozitat e Rregullës për Vendosjen e Çmimeve të Energjisë Termike, si dhe me parimet e avancuara të kontabilitetit dhe me Standardet Kosovare të Kontabilitetit.

Në këtë seksion do të tregohen në mënyrë tabelare shpenzimet e parashikuara siç janë prezantuar nga NQ Termokosi dhe shpenzimet operative të lejuara që ZRRE i ka aprovuar (Tabela 1.) Në vijim të tabelës është dhënë shpjegimi analitik për secilin pozicion të kostove operative.

Tabela 1: Kostot operative të paraqitura nga NQ Termokos SH.A., dhe ato të lejuara nga ZRRE (Në €)

Kostot Operative NQ Termokos - sezoni 2016/2017		Propozuar nga NQ Termokos	Lejuar nga ZRRE
Kostot Variabile			
1	Gjenerimi vetanak	230,000	230,000
2	Blerjet e energjise nga Kogjenerimi - komp. Variabile	334,298	334,298
3	Kemikaljet për trajtimin e ujit	60,000	35,000
4	Uji	85,000	75,000
5	Energjia elektrike (prodh. & Nënst. Distr.)	550,000	450,000
6	Kost. e personelit (puna direkte)	876,301	786,734
7	Taksa vjetore e licencave	0	1,017
8	Borxhi i keq i lejuar		273,447
9	Total kost. variabile	2,135,599	2,185,496
Kostot fikse			
10	Materialet, shërbimet	85,000	81,270
11	Riparimet e mirëmbajtja	150,000	107,670
12	Blerjet e energjise nga Kogjenerimi - komp. Fikse	737,954	737,954
13	Shpenzimet për administratë	65,000	55,000
14	Shpenzimet e personelit (te ndryshme nga puna direkte)	700,287	642,000
15	Kostot e shites dhe tjera administrative	700,000	75,000
16	Total kostot fikse	2,438,241	1,698,894
17	Totali i kostove operative	4,573,840	3,884,390




Figura 2: Paraqitja skematike e kostove kryesore (në €) të propozuara nga NQ Termokos dhe të pranuar (lejuara) nga ZRRE-ja për sezonin e ngrohjes 2016/2017

Shpjegim analitik

Në vijim janë dhënë shpjegime të detajizuara dhe arsyetimet për përcaktimin / lejimin për secilin grup të kostove respektivisht për pozicionet kryesore të kostove operative.

Kostot variabile:

- **Kostoja e blerjes së energjisë termike nga kogjenerimi në TC Kosova B – komponenta e pagesës për sasinë e energjisë termike:**
 - NQ Termokos ka propozuar koston totale të blerjes së energjisë termike nga kogjenerimi në vlerë prej 1,134,263 €. Kjo kosto është e bazuar në: kapacitetin e rezervuar sipas planifikimeve të Bilancit të energjisë dhe sasinë e planifikuar të energjisë termike, si dhe bazuar në çmimet e rregulluara respektive të gjenerimit të energjisë elektrike – Vendimi i ZRRE-së V_801_2016.
- Më konkretisht, Komponenta e pagesës për sasinë e energjisë termike është bazuar në sasinë e planifikuar prej 244,014 MWh_T dhe ngarkesën prej 1.27 €/MWh_T
- Vlerësimi – Propozimi i NQ Termokos vlerësohet se është kryesisht real dhe i bazuar, porse në propozimin e tyre NQ Termokos ka bërë disa gabime në llogaritje si dhe nuk e ka përfshirë komponentën e pagesës për taksën vjetore të licencimit (e cila do duhej llogaritur bazuar në taksën vjetore të licencave për prodhimin e energjisë termike të përcaktuar sipas Rregullës për Taksat të nxjerrë nga ZRRE. ZRRE ka kryer llogaritjet e veta që kanë rezultuar si në vijim:



- Komponenta e pagesës për sasinë e energjisë termike: 309,897 €; dhe
- Komponenta e pagesës për taksën vjetore të licencimit: 24,401 €.

Komponentët e lartpërshkruar rezultojnë komponentën e pagesës për sasinë e energjisë termike nga kogjenerimi në TC Kosova B, në vlerë prej **334,298 €** e cila lejohet për sezonin 2016/2017 .

- Është e vlefshme të përmendet se kostoja e tërësishme e blerjes së energjisë termike nga kogjenerimin në TC Kosova B – që përfshin komponentën për kapacitetin e rezervuar dhe komponentën për sasinë e energjisë termike – është **1,072,251 €**.
- **Kostoja e lëndës djegëse – mazutit:**
 - Kostoja e mazutit e propozuar nga Termokosi në vlerë prej 230,000 € është bazuar në sasinë e parashikuar të konsumit 1,000 ton dhe çmimin e parashikuar të blerjes prej 230 €/ton;
 - Vlerësimi – Me funksionalizimin e projektit të kogjenerimit stabilimentet (kaldajat) e prodhimit të energjisë termike janë kapacitet rezervë për tu aktivizuar vetëm në rastet e ndërprerjeve të paplanifikuara (avarive) të stabilimenteve të TC Kosova B. Kështu që përdorimi i tyre eventual do të zgjaste për periudha të shkurtëra gjersa të kryhen riparimet e nevojshme. Duke marrë parasysh se konsumi mesatar ditor, bazuar në të dhënat historike (14 vjeqare) vlerësohet të jetë rreth 70 ton/ditë, atëherë vlerësohet se sasia e planifikuar pre 1,000 ton është mjaftueshme për të prodhuar energji termike për një periudh rreth dy-javore. Sa i përket çmimit të blerjes, vlerësohet si real i bazuar në çmimin aktual në tregjet (bursat) ndërkombëtare – rreth 220\$/ton gjegjësisht rreth 190 €/ton; duke marrë parasysh se çmimi i furnizimit të mazutit përbëhet nga çmimi aktual i tregut dhe ‘premiumi’ për të mbuluar shpenzimet e furnizuesit (zakonisht është sjell 30 – 35 €/ton), atëherë mund të përfundohet se çmimi i dhënë nga NQ Termokos është real. Bazuar në sa u tha më lartë mund të vlerësohet se planifikimi për koston e mazutit propozuar nga NQ Termokos është real dhe ZRRE lejon **koston e mazutit** siq është propozuar në vlerë prej **230,000€**.
Lidhur me koston e mazutit për prodhimin vetanak të energjisë termike duhet theksuar se, edhe pse NQ Termokos nuk e ka paraqitur, ZRRE ka shtuar edhe koston për pagesën e taksës vjetore të licencimit. Kjo pagesë është llogaritur **1,017 €** bazuar në prodhimin e parashikuar të energjisë termike nga mazuti prej 10,170 MWh dhe taksën vjetore të licencimit 0.10 €/MWh (sipas Rregullës për taksat nxjerrur nga ZRRE.
- **Kostoja e ujit për (ri)mbushjen e sistemit të ngrohjes:**
 - NQ Termokos ka propozuar koston në vlerë prej 85,000 €, për sasinë e parashikuar të ujit 75,500 m³ për rimbushje të sistemit; kjo kosto paraqet një rritje të vogël në krahasim me realizimin në sezonin e kaluar 2015/2016.
 - Vlerësimi – ZRRE ka kryer vlerësimet duke u bazuar në konsumin e parashikuar dhe tarifat aktuale të shërbimeve të ujit për KRU Prishtina – për shërbimin e ujësjellësit: 0.88 €/ m³ dhe për shërbimin e ujrave të zeza: 0.105 €/m³. Rrjedhimisht, bazuar në llogaritjet përkatëse, lejon koston e ujit prej **75,000 €**, që vlerësohet si reale dhe e mjaftueshme.



- **Kostoja e kemikaljeve për trajtimin e ujit**

- NQ Termokosi ka propozuar koston e kemikaljeve për trajtimin e ujit në vlerë prej 60,000€, që paraqet një rritje shumë të madhe – rreth 236% - në krahsim me realizimin e kësaj kostoje në sezonin e kaluar (2015/2016).
- Vlerësimi – ZRRE vlerëson se shumica e propozuar është shumë e lartë dhe jo e bazuar, në rradhë të parë për shkak se realizimi i kësaj kostoje në sezonin e kaluar ka qenë dukshëm më i vogël – 17,858 €. Megjithatë duke marrë parasysh sasinë e ujit që duhet trajtuar, rrjedhjet e ujit (humbjet) dhe rritjen e planifikuar të sipërfaqes për ngrohje, ZRRE vlerëson se vlera prej **35,000 €** është e mjaftueshme për të mbuluar koston e kemikaljeve për trajtimin e ujit.

- **Kostoja e energjisë elektrike**

- Për koston e energjisë elektrike NQ Termokos ka propozuar vlerën prej 550,000 €, një vlerë kjo e rritur për 124,635 € ose rreth 29% krahasuar me vlerën e realizuar në sezonin e kaluar 2015/2016 (425,365 €). Kjo rritje është arsyetuar kryesisht me shtim të numrit të nënstacioneve për shkak të rritjes së bazës së konsumatorëve gjegjësisht shtimit të sipërfaqes ngrohëse dhe shtimin e pajisjeve të reja – kryesisht pompave rregulluese në 50 nënstacionet që janë në rehabilitim e sipër.
- Vlerësimi – Megjithëse arsyet e lartcekura qëndrojnë, ZRRE vlerëson se kjo rritje nuk korrespondon plotësisht me shtimin e numrit të nënstacioneve respektivisht sipërfaqes për ngrohje sepse përqindjet respektive janë dukshëm më të vogla se përqindja e rritjes së koston së parashikuar të energjisë elektrike. Rrjedhimisht vlerësohet se kostoja e lejuar e energjisë elektrike në vlerë prej **450,000 €** është e mjaftueshme për të mbuluar konsumin e tërësishëm të energjisë elektrike për periudhën në fjalë, përfshirë edhe shpenzimet shtesë për shkak të rritjes së sipërfaqes ngrohëse dhe instalimit të pajisjeve shtesë (të reja).

- **Kostoja e Personelit (“puna direkte”)**

- NQ Termokos ka paraqitur koston e personelit – “puna direkte”, në vlerë prej 876,301 €, që paraqet një rritje prej rreth 17% në krahasim me realizimin në periudhën e kaluar. Për këtë parashikim nuk kanë ofruar detaje të kërkuara në komentet me shkrim të ZRRE-së, përveq se është dhënë një shënim që “është parashikuar rritje prej 20%...”.
- Vlerësimi – Rritja e propozuar nga NQ Termokos nuk përmban detajet e nevojshme si: shtimin e numrit të punëtorëve, shtimin e pagave, pagën mesatare etj, që janë të domosdoshme për të arsyetuar rritjen e propozuar. Po ashtu nuk ka ndonjë zgjerim të dukshëm të operimeve të NQ Termokos që do implikonte shtim të dukshëm të numrit të punëtorëve. Rrjedhimisht ZRRE vlerëson se një rritje prej 5% e kësaj kostoje është e arsyeshme dhe lejon vlerën **786,734 €** për Koston e personelit (‘puna direkte’).



- **Kostoja e Borxheve të këqija**

- Siq theksohet më poshtë nën seksionin 'kostot fikse', NQ Termokos e ka futur këtë kosto nën pozicionin 'kostot e shitjes dhe tjera administrative' duke paraparë vlerën që korrespondon me 10% të faturimit të planifikuar.
- Vlerësimi - Në pajtim me dispozitat e Rregullës për Vendosjen e Çmimeve të Energjisë Termike, kostoja e borxhit të keq llogaritet si përqindje e arsyeshme në të hyrat e ndërmarrjes (dmth. vlerën e faturimit nga shitja e ngrohjes). Kjo 'përqindje e arsyeshme' duhet të caktohet në atë mënyrë që të nxis ndërmarrjen për të shtuar përpjekjet për rritjen e nivelit të arkëtimit të pagesave nga konsumatorët, por njëkohësisht merr parasysh se një shumë e konsiderueshme objektivist nuk mund të arkëtohet, pra do të mbetet si borxh që faktikisht nuk do të realizohet. Nga sa u tha më lartë ZRRE mendon se niveli i borxhit të keq prej 5% është i arsyeshëm, dhe rrjedhimisht e lejon koston e borxhit të keq në vlerën prej **273,447 €**.

Nga më lartë rezulton se **Kostot Variabile** të pranuar nga ZRRE-ja janë përcaktuar në vlerën **2,185,496 €**.

Kostot fikse

- **Kostoja: Riparimet dhe Mirëmbajtja;**

- NQ Termokos për koston e riparimeve dhe mirëmbajtjes ka planifikuar vlerën prej 150,000€ - pra një rritje të dukshme prej 90,350 € ose 151% krahasuar me realizimin e kësaj kostoje në periudhën e kaluar / sezonin 2015-2016 (59,650 €). Gjithashtu paraqitet rritje prej 63,864 € krahasuar me koston e realizuar sipas Pasqyrave financiare për vitin 2015.
- Vlerësimi - ZRRE vlerëson se një rritje e tillë mjaft e madhe nuk është e arsyetuar mjaftueshëm dhe nuk reflektohen plotësisht shpenzimet e zakonshme për riparimet dhe mirëmbajtjen që i shkaktohen ndërmarrjes. Duke marrë parasysh shtimin e sipërfaqes ngrohëse gjegjësisht kyqjet e reja të planifikuara, sigurimin e një furnizimi cilësor dhe operim të qëndrueshëm të stabilimenteve, pajisjeve dhe rrejtit, konkludohet se një rritje prej rreth 25% në krahasim me koston e realizuar ë vitin 2015 është e arsyeshme. Rrjedhimisht ZRRE lejon koston e riparimeve dhe mirëmbajtjes në vlerën prej **107,670 €**.

- **Kostoja: Materialet dhe Shërbimet:**

- Për këtë pozicion nga NQ Termokos është propozuar vlera prej 85,000 €, për të cilën nuk është dhënë ndonjë detajizim ose arsyetim përkatës; kjo vlerë paraqet rritje prej 19,986 € ose rreth 30% nga realizimi në periudhën e kaluar / sezoni 2015-2016 (65,014€).
- Vlerësimi – Duke marrë parasysh se kjo kosto është ngusht e ndërlidhur me koston e riparimeve dhe mirëmbajtjes, vlerësohet se është nevojshme të aplikohet një rritje e njëjtë si për koston e riparimeve dhe mirëmbajtjes – pra rritje prej 25% nga vlera e realizuar e koston 'Materialet dhe shërbime'. Kështu ZRRE lejon koston 'Materialet dhe Shërbimet' në vlerë prej **81,270 €**.



- **Kostoja e blerjes së energjisë termike nga kogjenerimi në TC Kosova B – komponenta e pagesës për kapacitetin e rezervuar**
 - Komponenta e pagesës për kapacitet të rezervuar e propozuar nga NQ Termokos është bazuar në kapacitetin e rezervuar elektrik: 37,214 MWh_{EL}/h dhe ngarkesën respektive: 19.83 €/MWh_{EL}/h;
 - Vlerësimi – Propozimi i NQ Termokos vlerësohet se është kryesisht real dhe i bazuar, porse në propozimin e tyre NQ Termokos ka bërë gabim në llogaritje. ZRRE ka kryer llogaritjet e veta që ka rezultuar se Komponenta e pagesës për kapacitetin e rezervuar është **737,954€**;

- **Kostot Administrative:**
 - NQ Termokos ka propozuar koston për administratë në vlerë prej 65,000 € pa ofruar ndonjë detajim ose arsyetim mbështetës. Vlera e propozuar tregon rritje prej 13,658 € ose rreth 27% krahasuar me vlerën e realizuar në periudhën e kaluar, e gjithashtu paraqet rritje të konsiderueshme krahasuar me vlerën e deklaruar në Pasqyrat financiare për vitin 2015.
 - Vlerësimi – Bazuar në faktin se kostot administrative klasifikohen si kosto e pastër fikse që nuk mvaren nga sasitë e prodhuara dhe furnizuara të energjisë termike, ZRRE konsideron se nuk ka arsye të qëndrueshme për ndonjë rritje të dukshme të kësaj kostoje. Megjithatë për të lejuar përmirësimin e shërbimeve të ndërmarrjes e veçanërisht shërbimin për konsumatorë, ZRRE vendos të lejoj një rritje të vogël nga realizimi në periudhën e kaluar dhe e fikson këtë kosto në vlerën **55,000 €**.

- **Kostoja e Personelit ('e ndryshme prej punës direkte')**
 - Për koston e personelit në administratë dhe shërbimet tjera mbështetëse NQ Termokos ka propozuar vlerën prej 700,287 € - njëjtë si për 'koston e personelit - puna direkte', edhe ky është propozim i rritur prej 88,523 € ose 14% në krahasim me realimin e kësaj kostoje në periudhën e kaluar (611,764€).
 - Vlerësim – Njëjtë si për koston e personelit 'puna direkte', rritja e propozuar nga NQ Termokos nuk përmban detajet e nevojshme si: shtimin e numrit të punëtorëve, shtimin e pagave, pagën mesatare etj, që janë të domosdoshme për të arsyetuar rritjen e propozuar. Po ashtu, nuk ka ndonjë zgjerim të dukshëm të operimeve të NQ Termokos që do implikonte shtim të dukshëm të numrit të punëtorëve. Rrjedhimisht ZRRE vlerëson se një rritje prej rreth 5% e kësaj kostoje nga kostoja e realizuar në periudhën e kaluar është e arsyeshme dhe lejon vlerën prej **642,000 €**.

- **Kostot e shitjes dhe tjera administrative**
 - Kjo kosto është propozuar nga NQ Termokos në vlerë tejet të madhe 700,000 €, ndërkaq që për këtë propozim nuk kanë ofruar ndonjë detajim ose shpjegim mbështetës.
 - Vlerësimi – Nga raportimet e realizimeve të viteve të kaluara për ZRRE-në ka qenë e njohur se, në këtë kategori kostoja më e madhe është "shpenzimet e provizioneve të llogarive të arkëtueshme" – për ilustrim, në sezonin e kaluar kostot e shitjes dhe tjera administrative kanë qenë 529,771 €, ku pjesa kryesore i ka takuar nën-komponentës



“shpenzimet e provizioneve të llogarive të arkëtueshme¹” në vlerë prej 458,263 €. Për këtë në komentet tona me shkrim kemi kërkuar sqarime shtesë dhe njëkohësisht kemi potencuar faktin se në përputhje me dispozitat e Rregullës për vendosjen e çmimeve të energjisë termike, ZRRE e përcakton / lejon një përqindje të arsyeshme të nivelit të borxheve të këqija. Duke qenë se kostoja e borxheve të këqija është kategorizuar dhe trajtuar nën kostot variabile, ZRRE ka fiksuar vlerën **75,000 €**, si vlerë të lejuar për Kostot e shitjes dhe tjera administrative, e cila nuk i përfshin “shpenzimet e provizioneve të llogarive të arkëtueshme”,.

Nga më lartë rezulton se **Kostot Fikse** të pranuar nga ZRRE-ja, janë përcaktuar në vlerën **1,698,894 €**.

- Total Kostot operative të lejuara

Kostot operative të lejuara përbëhen nga shuma e kostove fikse dhe atyre variabël, dhe janë llogaritur sipas formulës së shënuar më poshtë:

OC = Kostot Variabile + Kostot Fikse

Nga formula llogariten:

Kostot operative të lejuara në vlerë prej 3,884,390 €




Figura 3: Paraqitja skematike e kostove operative të propozuara nga NQ Termokos dhe të lejuara nga ZRRE-ja për sezonin e ngrohjes 2016/2017

¹ Në Pasqyrat financiare statutorë për vitin 2015 në Raportin e auditimit kjo nën-komponentë paraqitet në të njëjtën vlerë por me emërtimin “Lejimet për borxhet e këqija dhe të dyshimta”



3.2 Përcaktimi i Bazës së Rregulluar të Aseteve (RAB)

Përcaktimi i RAB-it është faktori kryesor për llogaritjen e Zhvlerësimit vjetor dhe Kthimit të lejuar në asete, që në fakt paraqet fitimin e lejuar nga aktiviteti afarist i rregulluar.

Baza e Rregulluar e Aseteve - RAB, në pajtim me shtojcën 2 të Rregullës për Vendosjen e Çmimeve të Energjisë Termike llogaritet sipas formulës:

$$RAB_n^{end} = RAB_n^{start} + INV_n - DIS_{n-1} - DEP_{n-1} + WC_n$$

Duke qenë se në këtë sezon zhvillohet procesi i shqyrtimit tarifor pas një periudhe katër vjeçare, gjatë së cilës asetet e NQ Termokos kanë pësuar ndryshime të dukshme në strukturë dhe në vlerën monetare, kryesisht për shkak të investimeve në projektin e kogjenerimit, atëherë konsiderohet se përcaktohet RAB-i fillestar, dhe rrjedhimisht formula modifikohet si më poshtë:

$$RAB = \text{Vlera Neto Kontabël e Aseteve Ekzistuese (pas Zhvlerësimit të akumuluar)} + INV \text{ (Investimet e reja)} + WC \text{ (Kapitali Punues)} - DIS \text{ (Tjetërsimet)}.$$

3.2.1 Përcaktimi i Aseteve Ekzistuese

Për shkak të specifikave të NQ Termokos, kryesisht të kushtëzuar nga implementimi i projektit të kogjenerimit, ku ka pasur rritje të madhe të aseteve, ZRRE ka vendosur që vlerësimi i aseteve ekzistuese të bëhet ndarazi për dy nën-komponentet vijuese:

- a) **Asetet ekzistuese pa asetet e projektit të kogjenerimit** – këto asete përfshijnë asetet e regjistruara prej vitit 1992 (sipas ri-evaluimit të aseteve të atij viti) e tutje, dhe për të cilat ekzistojnë informacione të mangëta, në kuptim të mënyrës së financimit, metodave të ri-evaluimit që janë kryer deri më tani etj.
- b) **Asetet ekzistuese të projektit të kogjenerimit** – këto asete janë si rezultat i investimeve në projektin e kogjenerimit që është funksionalizuar në fund të nëntorit 2014, dhe për të cilat posedojmë informacion të mjaftueshëm.

a) Asetet ekzistuese pa asetet e projektit të kogjenerimit

Për vlerësimin e këtyre aseteve, si burim informacioni është përdorur kryesisht Lista e aseteve dorëzuar nga NQ Termokos. Siç është përshkruar në formulën më lartë, për vlerësim do të merret Vlera neto kontabël e tanishme (viti 2016) dmth. pas zhvlerësimit të akumuluar; llogaritja si në vijim:

$$\text{Vlera neto kontabël e tanishme} = \text{Vlera Fillestare} - \text{Zhvlerësimi i akumuluar} = 13,621,957 \text{ €} - 7,601,132 \text{ €} = \mathbf{6,020,825 \text{ €}}$$

Bazuar në kategorizimin sipas Listës së aseteve dhe gjithashtu duke ju referuar praktikave ndërkombëtare rregullative, Asetet ekzistues janë kategorizuar me vlerat përkatëse monetare si në vijim:



Tabela 2: Kategorizimi i Aseteve ekzistuese pa asetet e projektit të kogjenerimit me vlerat përkatëse

Kategoritë	Vlera e Aseteve [€]
Stabilimentet, pajisjet dhe instalimet elektro-mekanike	434,539
Rrjeti - Tubacionet, fittingjet dhe pajisjet përbërëse	5,560,525
Pajisjet TI, instrumentet e sist. Kontroll., dhe invent. imët i zyrës	25,761
Total Asetet Ekzistuese pa asetete e projekt.të kogjenerimit	6,020,825

Ky kategorizim shërben për të llogaritur projeksionet e Zhvlerësimit vjetor, ku sipas praktikave rregullative për secilën kategori përcaktohen norma të ndryshme të zhvlerësimit gjegjësisht jetëgjatësia e asetëve (më detajisht në kapitullin 3.3: Përcaktimin i Zhvlerësimit Vjetor).

Mënyra e Financimit

Siç u përmend më lartë, për këto asete ekzistojnë informata të mangëta për mënyrën e financimit të tyre. Sidoqoftë, për asetet e fituara pas vitit 1999 është e njohur se, një pjesë e konsiderueshme e asetëve është financuar nga donacionet, por që mungojnë të dhëna të sakta për vlerat e financimit të asetëve përmes donacioneve respektivisht financimit me mjete vetanake. Rrjedhimisht, ZRRE vendos që të përdor proporcionin 75% (financim nga donacionet) : 25% (financim vetanak). Sipas këtij proporcioni llogariten vlerat përkatëse të financimit të asetëve bazuar në vlerë totale 6,020,826 €, si në vijim:

- (Asetet ekzistuese pa asetet e projektit të kogjenerimit)_{DONACION} = 4,515,619 €; dhe
- (Asetet Ekzistuese pa asetet e projektit të kogjenerimit)_{VETFINANC.} = 1,505,206 €.

b) Asetet ekzistuese të projektit të kogjenerimit

Për vlerësimin e asetëve të projektit të kogjenerimit, ZRRE ka shfrytëzuar informatat nga NQ Termokos – Listën e asetëve dhe të dhënat nga monitorimet e rregullta të investimeve, si dhe të dhënat dhe informatat nga Banka Gjermane për Zhvillim (KfW) si promotor i projektit. Lidhur me këtë duhet theksuar se asetet e këtij projekti, në Listën e asetëve janë të regjistruara si tërësi – pra jo të ndara sipas kategorive / departamenteve përkatës të ndërmarrjes. Ndërsa të dhënat nga KfW dhe të dhënat nga monitorimet e rregullta përmbajnë detajet e nevojshme, të cilat janë paraqitur të përmbledhura në vijim.

- Pakoja 1: Linja gupore (rrjeti i transportit) të energjisë termike 15,239,256 €
 - Punët ndërtimore për trasenë e rrejtit;
 - Blerja dhe furnizimi i gypave;
 - Instalimet gypore dhe fittingjet.
- Pakoja 2: Stacionet e Shkëmbyesve të energjisë termike 15,613,444 €
 - Stacioni i ekstraktimit të energjisë termike në TC Kosova B;
 - Stacioni i pranimit të energjisë termike në NQ Termokos;



- Instalimet e ekstraktimit të avullit në turbinat e njësive B1 dhe B2;
- Instalimet e lidhjes me rrjetin e shpërndarjes të NQ Termokos.

Duke ju referuar kategorizimit të përshkruar më lartë, Pakoja 1 klasifikohet nën kategorinë: Rrjeti - Tubacionet, fittingjet dhe pajisjet përbërëse, ndërsa Pakoja 2 nën kategorinë: Stabilimentet, pajisjet dhe instalimet elektro-mekanike – tabela më poshtë.

Tabela 3: Kategorizimi i Aseteve të projektit të kogjenerimit me vlerat përkatëse

Kategoritë	Vlera e Aseteve [€]
Stabilimentet, pajisjet dhe instalimet elektro-mekanike	15,613,444
Rrjeti - Tubacionet, fittingjet dhe pajisjet përbërëse	15,239,256
Total Asetet Ekzistuese të projekt.të kogjenerimit	30,852,700

Vlera neto kontabël e tanishme e asetëve të kogjenerimit

Vlera neto kontabël e tanishme llogaritet duke zbritur zhvlerësimin e akumuluar nga vlera fillestare (në kohën e vënies në operim). Për të llogaritur zhvlerësimin e akumuluar, për periudhë prej datës së vënies në operim gjer më tani, është përdorur norma mesatare e zhvlerësimit për asetet e kogjenerimit prej 6.67% e nxjerrun nga Lista e asetëve.

Kjo normë e llogaritit 6.67% është përdorur për të llogaritur zhvlerësimin e akumuluar për secilën kategori të asetëve. Rrjedhimisht, vlera neto kontabël e tanishme e asetëve të kogjenerimit (pas zbritjes së zhvlerësimit të akumuluar) përcaktohet si në vijim:

- Vl. neto kont.: Pako 1 / Rrjeti - Tubacionet, fittingjet dhe pajisjet përbërëse:	14,222,798 €;
- Vl. neto kont.: Pako 2 / Stabil., pajisjet dhe inst. elektro-mekanike:	14,572,027 €;
- Total Vlera neto kontabël e tanishme e asetëve të kogjenerimit:	28,794,825 €

Mënyra e Financimit

Fillimisht duhet theksuar se pjesa më e madhe e investimeve të projektit të kogjenerimit ka qenë donacione (nga Qeveria Gjermane, Komisioni Evropian dhe nga Institucionet vendore qendore dhe lokale); përderisa shuma prej 5,000,000 € është kredi nga KfW me normë interesi vjetor prej 8.79% me afat kthimi 11 vjet. Normalisht financimi përmes kreditimit konsiderohet si vetëfinancim i ndërmarrjes, dhe rrjedhimisht konkludohet si në vijim:

- (Asetet ekzistuese të projektit të kogjenerimit)_{DONACION} = 23,794,825 €; dhe
- (Asetet Ekzistuese të projektit të kogjenerimit)_{VETFINANC.} = 5,000,000 €.

Përmbledhje - Përcaktimi i Vlerës neto kontabël të Asetëve ekzistuese

Siç u përmend në fillim të këtij kapitulli, asetet ekzistuese llogariten si në vijim:



- Asetet ekzistuese pa asetet e projektit të kogjenerimit (a):	6,020,825 €;
- Asetet ekzistuese të projektit të kogjenerimit (b):	28,794,825 €;
- Total Asetet ekzistuese (VI. Neto kont.):	34,815,650 €

Njëjtë si më lartë vlera totale e aseteve ekzistuese ndahet sipas mënyrës së financimit, si në vijim:

- (Asetet ekzistuese)_{DONACION} = 28,310,444 €; dhe
- (Asetet Ekzistuese)_{VETFINANC.} = 6,505,206 €.

3.2.2 Përcaktimi i Investimeve të reja të lejuara

Investimet e reja të planifikuara për periudhën 2016-2017 kryesisht i përkasin rehabilitimit të rrjetit e nënstacioneve dhe zgjerimit të rrjetit; këto projekte planifikohen në pjesën më të madhe të financohen nga donacionet ndërsa një shumë e vogël me vetëfinancim – detajet në vijim:

- Investimet në vlerë totale prej **4,483,032 €** janë në kuadër të projektit që është në vijim e sipër për rehabilitimin e rrjetit dhe nënstacioneve. Pra siq u tha më lartë punimet në kuadër të projektit janë duke u zhvilluar ende (nuk janë plotësisht të përfunduara), kështu që konsiderohen 'investime në vijim' dhe përfshihen në Investimet e reja të lejuara.

Detajet e financimit:

- Donacion nga Qeveria Gjermane përmes KfW dhe Komuna e Prishtinës: 4,133,032 €;
- Vetëfinancim nga NQ Termokos: 350,000 €

- Investimet në vlerë totale të planifikuar prej **7,093,610 €** janë të dedikuara kryesisht për zgjerim të rrjetit dhe një pjesë më e vogël për rehabilitim të rrjetit dhe modernizim të pajisjeve përbërse. Vlera investive e planifikuar është pjesë e projektit më të gjerë në kuadër të IPA 2015, që kryesisht planifikohet të financohet nga donacionet e Komisionit Evropian (KE) dhe i Qeverisë Gjermane përmes KfW, dhe një pjesëmarrje e vogël si donacion nga Komuna e Prishtinës dhe vetëfinancim nga NQ Termokos – këto janë 'zotime' të bëra nga Institucionet ndërkombëtare dhe vendore.

Detajet e financimit:

- Donacion i KE: 3,250,000 €;
- Donacion i Qeverisë Gjermane përmes KfW: 2,978,610 €;
- Donacion i Komunës së Prishtinës: 625,000 €;
- Vetëfinancim i NQ Termokos: 240,000 €.

Përmbledhje e Investimeve të reja të lejuara

Duke qenë se ZRRE ka përcjellur në vazhdimësi zhvillimin e këtyre projekteve investive dhe në kuadër të bashkëpunimit me palët e kyqura në këto projekte është informuar saktësisht për detajet e këtyre projekteve, i pranon në tërësi investimet e reja të paraqitura nga NQ Termokos; Pra lejohen **Investimet e reja** në vlerë totale prej **11,576,642 €**.



Ndarja sipas kategorive të aseteve:

Projektet investive të lartë-përshkruara janë kryesisht të dedikuara për rrjetin e shpërndarjes së NQ Termokos dhe nënstacioneve si pjesë përbërse e rrjetit, kështu që e të vlera e planifikuar e Investimeve të reja (**11,576,642 €**) klasifikohet nën kategorinë: **Rrjeti - Tubacionet, fittingjet dhe pajisjet përbërëse.**

Ndarja sipas mënyrës së financimit:

Duke ju referuar detajeve të financimit të përshkruara më lartë ndarja e Investimeve të reja të lejuara sipas mënyrës së financimit është si më poshtë:

- (Investimet e reja të lejuara)_{DONACION} = 10,986,642 €; dhe
- (Investimet e reja të lejuara)_{VETFINANC.} = 590,000 €.

3.2.3 Përcaktimi i Kapitalit Punues

Sipas dispozitave përkatëse të Rregullës për Vendosjen e Çmimeve të Energjisë Termike – Shtojca 2, kapitali punues zakonisht përcaktohet për të lejuar mjete monetare qarkulluese për një periudhë jo më të gjatë se një muaj respektivisht vlerën e të hyrave mesatare mujore. Rrjedhimisht, ZRRE përcakton raportin 1/12 në të hyrat nga shitja e ngrohjes të realizuara në sezonin 2015/2016 dhe lejon kapitalin punues në vlerën **455,745 €**.

3.2.4 Tjetërsimet

Me tjetërsim nënkuptohet asetet që ndërmarrja e rregulluar i ka hequr nga përdorimi – asetet që janë dëmtuar në atë masë sa që nuk mund të riparohen dhe të përdoren përsëri, asetet që eventualisht janë shitur/huazuar (kur janë vlerësuar të papërdorshme) etj; Sipas formulës së dhënë në fillim të kapitullit 3.2, vlera e aseteve të tjetërsuara është e zbritshme (minusohet). Duke qenë se në këtë shqyrtim tarifor është marrë vlera neto kontabël e aseteve sipas Listës së aseteve të azhurnuar në gjysmën e parë të këtij viti e po ashtu nga NQ Termokos nuk është raportuar ndonjë tjetërsim pas azhurnimit të Listës së aseteve, Vlera për tjetërsimet është **0€**.

Përmbledhje e përcaktimit të RAB-it dhe RAB_f

Në tabelën vijuese paraqiten të përmbledhura komponentet përbërse dhe vlerat respective të Bazës së Rregulluar të Aseteve (RAB) dhe Bazës së Rregulluar të Aseteve të vetëfinancuara (RAB_f).

Tabela 4: RAB dhe komponentët e tij - NQ TERMOKOS sezoni i ngrohjes 2016/2017

Baza e Rregulluar e Aseteve (RAB) - NQ TERMOKOS Sezoni i ngrohjes 2016-2017		Lejuar nga ZRRE [€]
3.2.1	Vlera neto kontabël e aseteve fikse (pas zhvlerësimit të akumuluar)	34,815,650
3.2.2	Investimet e Reja	11,576,642
3.2.3	Kapitali Punues	455,745
	Baza e Rregulluar e Aseteve (RAB)	46,848,037



Tabela 5: RAB_f dhe komponentët e tij - NQ TERMOKOS sezoni i ngrohjes 2016/2017

Baza e Rregulluar e Aseteve e vetëfinancuar (RAB _f)- NQ TERMOKOS Sezoni i ngrohjes 2016-2017		Lejuar nga ZRRE [€]
3.2.1	Vlera neto kontabël e asetëve fikse (pas zhvlerësimit të akumuluar) pa donacione	6,505,206
3.2.2	Investimet e Reja (pa donacione)	590,000
3.2.3	Kapitali Punues	455,745
Baza e Rregulluar e Aseteve e vetëfinancuar (RAB_f)		7,550,951

3.3 Vlerësimi dhe Përcaktimi i Zhvlerësimit Vjetor

Bazuar në kategorizimin e asetëve dhe vlerave përkatëse të dhënë në tabelën 2 – kapitulli 3.2.1 (a) dhe tabelën 3 – kapitulli 3.2.1 (b), në tabelën 6 është dhënë në mënyrë të përmbledhur kategorizimi i RAB-it sipas kategorive të asetëve, jetëgjatësia respektive gjegjësisht norma e zhvlerësimit për secilën kategori të asetëve, si dhe norma mesatare e ponderuar e zhvlerësimit.

Tabela 6: Kategorizimi i RAB dhe norma mesatare e ponderuar e zhvlerësimit

Kategoritë	Vlera e Aseteve [€]	Jetëgjatësia e aseteve [vite]	Norma e Zhvlerësimit
Stabilimentet, pajisjet dhe instalimet elektro-mekanike	15,006,566	25	4%
Rrjeti - Tubacionet, fittingjet dhe pajisjet përbërëse	31,359,965	35	2.86%
Pajisjet TI, instrumentet e sist. Kontroll., dhe invent. imët i zyrës	25,762	5	20%
Total RAB - Kap. Pun. /Norma mesatare e ponderuar e zhvlerësimit	46,392,293		3.24%

Siq vërehet nga tabela më lartë norma mesatare e ponderuar e zhvlerësimit (NZ_{MP}) është llogaritur 3.24%. Bazuar në vlerën totale të (RAB-it – Kapitali punues) dhe Normën mesatare të ponderuar të zhvlerësimit, llogaritet Zhvlerësimi vjetor i lejuar, si në vijim:

$$\text{Zhvlerësimi vjetor i lejuar} = \text{Total RAB} * NZ_{MP} = 46,392,293 \text{ €} * 3.24 \% = \mathbf{1,501,414 \text{ €}}$$

3.4 Përcaktimi i Kthimit të Lejuar në RAB (Fitimi i Lejuar)

Siç u përmend më parë, llogaritja/përcaktimi i Kthimit të lejuar llogaritet bazuar në Bazën e Rregulluar të Aseteve të vetëfinancuara RAB_f) dhe Normën e kthimit (RoR), pra përfshin dy komponentet në vijim:

- Përcaktimin (vendosjen) e Bazës së Rregulluar të Aseteve të vetëfinancuar (RAB_f); dhe
- Llogaritjen e Normës së Kthimit të lejuar (RoR), të përcaktuar në vlerën e WACC-ut.



Komponenta e parë - RAB_f është llogaritur në kapitullin 3.2 – tabela 5, ndërsa llogaritja e komponentës së dytë – RoR përcaktohet në kapitullin vijues:

3.4.1 Llogaritja e Normës së Kthimit (RoR) të Lejuar

Objektivi i Normës së kthimit të arsyeshme (RoR) në Bazën e rregulluar të asetëve (RAB), është që të garantoj ndërmarrjet e ngrohjes qendrore për një fitim që lejon të vazhdohet me investimet në asete, në mënyrë që të mund ti rehabilitoj dhe ti zgjeroj ato.

Një RoR i arsyeshëm konsiderohet të jetë norma e “Mesatares së Ponderuar të Kostos së Kapitalit” (WACC), që llogaritet në komponentët e bazës së kapitalit, duke marrë parasysh ponderimet e shumave të këtyre komponenteve të kapitalit. Me fjalë tjera, WACC-u është shuma e mesatares së ponderuar të kostos së ekuitetit dhe kostos së borxhit.

Për koston e ekuitetit, ZRRE-ja ndjek metodologjinë e njohur ndërkombëtare të quajtur “Modeli i Çmimit të Kapitalit të Aseteve” (CAPM). CAPM shpreh koston e pritur të ekuitetit si një normë pa rrezik (r_f) plus premiumin e rrezikut të ekuitetit (ERP). Ne mund ta definojmë ERP si ndryshimin mes rrezikut të tregut të ekuitetit – d.m.th. kthimi i pritur nga tregu i zhvilluar mirë – dhe normën e kthimit pa rrezik, e që shprehet me formulën e paraqitur më poshtë:

$$ERP = (r_m - r_f)$$

Norma e ERP varet nga rreziku i investimit në një treg të një vendi të veçantë.

Vlera e WACC-ut para tatimeve mund të llogaritet sipas formulës në vijim:

$$WACC_{pre-tax} = [(D/V)*k_d] + [(E/V)*k_e]$$

ku:

D/V	Raporti i borxhit ndaj totalit të bazës së kapitalit (si përqindje)
E/V	Raporti i ekuitetit ndaj totalit të bazës së kapitalit (si përqindje)
V	Totali i bazës së kapitalit, që është shuma e ekuitetit dhe borxhit
k_d	Kostoja e Borxhit
k_e	Kostoja e ekuitetit

Kostoja e borxhit (k_d) është zotim kontraktual dhe është norma interesit që ndërmarrja paguan në huatë (kreditë) aktuale.

Kostoja e ekuitetit (k_e) llogaritet si në vijim:

$$k_e = r_f + \beta_e * (r_m - r_f)$$

Ku:

r_f Norma pa rrezik dhe nxjerret nga vlerësimet për kthimin në obligacionet (“bondet”) e qeverisë



β_e "Beta": masa e rrezikut për kompaninë përkatëse
 $(r_m - r_f)$ Premiumi i rrezikut të tregut të ekuitetit minus norma e kthimit pa rrezik

"Premiumi i rrezikut" është përcaktuar nga "beta" dhe nga premiumi i rrezikut të pritur të një tregu, e që investitorët e kërkojnë nga tregu si tërësi. Faktori "beta" matë pa-parashikueshmërinë e kthimit të një kompanie në relacion me tregun e mallrave (aksioneve) si tërësi.

Më poshtë ne vlerësojmë / llogarisim koston e borxhit dhe koston e ekuitetit për ndërmarrjet e ngrohjes qendrore në Kosovë, për të ardhur tek WACC para tatimeve.

Kostoja e Borxhit

Për këtë sezon të ngrohjes dhe sezonët vijues, ZRRE-ja ka vendosur që raporti D/V në vlerën 60/100 (60% borxh dhe 40% ekuitet). Ky raport 60% duhet të përdoret në vlerësimet / llogaritjet e WACC-ut komercial para tatimeve për sezonin e ngrohjes 2016 – 2017, si dhe për sezonët vijues, nëse nuk vërehen ndryshime domethënëse.

Aktualisht NQ Termokos ka huanë nga KfW me normë interesi 8.79% (detajet ne kapitullin 3.2.1). Rrjedhimisht kostoja e borxhit do te reflekton kredinë aktuale dhe fiksohet në vlerën **8.79 %**.

Pra Kostoja e borxhit është:

$$k_d = 8.79 \%$$

Kostoja e Ekuitetit

Kostoja e ekuitetit paraqitet me formulën më poshtë:

$$k_e = r_f + \beta_e * (r_m - r_f)$$

ku:

$$ERP = (r_m - r_f)$$

Vendimet e fundit të autoriteteve rregullative e vlerësojnë premiumin e rrezikut në ekuitet në rangun prej 3.5 gjer në 5%. Për shkak se NQ Termokos është ndërmarrje publike konsiderohet se rreziku në ekuitet është minimal dhe rrjedhimisht përvetësohet vlera e **ERP-së të jetë e barabartë me 3.5%**.

Beta mesatare e aseteve për rrjetet e energjisë elektrike në BE dhe për ndërmarrjet e integruara është 0.42 e krahasuar me 0.54 - 0.63 për ndërmarrjet që kanë vetëm gjenerimin dhe furnizimin në BE dhe SHBA. Për shkak se industria e ngrohjes qendrore ne Kosovë është e vogël, duket e arsyeshme qe të supozojmë se rritja e kërkesës – që është faktori kryesor për rritjen e të ardhurave – do të jetë më e pa-parashikueshme se sa rritja e GDP – që është faktori kryesor për rritjen e tregut të mallrave dhe aksioneve – se sa në vendet e mëdha dhe të zhvilluara. Shtimi i një konsumatori të vetëm të madh në ngrohjen qendrore do të thotë rritjen e kërkesës për ngrohje qendrore në krahasim me kërkesën e mëparme, përderisa ndikim në GDP mund të jetë shumë më i vogël. Në mënyrë që ta marrin në konsideratë natyrën më të pa-parashikueshme të të ardhurave



të ndërmarrjeve të ngrohjes qendrore në krahasim me rritjen e GDP, ne vlerësojmë që kostoja e ekuitetit të jetë më e lartë se sa mesatarja e vendosur nga rregullatorët e BE-së, dhe ne konsiderojmë se “ β_e ” e arsyeshme për ndërmarrjet e ngrohjes qendrore në Kosovë si më poshtë:

$$\beta_e = 1$$

Kostoja e ekuitetit pas tatimeve është si në vijim:

$$k_{e \text{ post tax}} = 1.5\% + (1 * 3.5\%) = 5.00\%$$

Kostoja e ekuitetit para tatimeve gjendet duke shumëzuar rezultatin më lartë të koston së ekuitetit pas tatimeve me relacionin që e konsideron tatimin (“tax wedge”) si më poshtë:

$$\text{Tax wedge} = 1/(1-t)$$

ku:

t Shkalla e tatimit në fitimin e kompanive

Tatimi në fitim (t) në Kosovë është 10% dhe relacioni që e konsideron tatimin (“tax wedge”) është:

$$1/(1-0.10) = 1.11$$

Kostoja e ekuitetit para tatimeve është:

$$k_{e \text{ pre-tax}} = 5.00\% * 1.11 = 5.55\%$$

Si rrjedhim i llogarive më lartë llogaritet WACC-u para tatimeve – i rrumbullakuar në dy decimale – si më poshtë:

$$WACC_{\text{pre-tax}} = [8.79\% * 0.6] + [5.55\% * 0.4] = 7.50\%$$

Llogaritja e Kthimit të Lejuar në RABf (Profitit të Lejuar) për NQ Termokos

Bazuar në $WACC_{\text{pre-tax}}$ e llogaritur prej 8.42% në 3.4.1, llogaritet Kthimi i lejuar apo Profitit i lejuar për NQ Termokos, sipas formulës më poshtë:

$$RET = RoR \times RAB_f$$

Pra **Kthimi i lejuar në RAB_f** është i barabartë me $7,550,952\text{€} * 7.50\% = 566,036 \text{€}$.



Tabela 6: Kthimi i Lejuar (Profiti i Lejuar) në RAB_f për NQ TERMOKOS për sezonin e ngrohjes 2016-2017

Kthimi i Lejuar (Profiti i Lejuar) në RAB _f për NQ TERMOKOS		Lejuar nga ZRRE [€]
RAB _f	Baza e Rregulluar e Aseteve - vetëfinancuar	7,550,952
RoR	Norma e Kthimit në vlerën e WACC	7.50%
	Kthimi i Lejuar ose Profiti i Lejuar	566,036

3.5 Përcaktimi i Kostos së Humbjeve në Rrjet

Kostoja e lejuar e humbjeve të rrjetit shërben për të mbuluar kostot që i shkaktohen ndërmarrjes për shkak të humbjeve të energjisë termike gjatë transportit dhe shpërndarjes. Në përputhje me Shtojcën 1 të Rregullës për Vendosjes e Çmimeve të Energjisë Termike kjo kosto llogaritet si herësi në mes të humbjeve sasiore të rrjetit dhe gjenerimit të energjisë termike që hyn në rrjet (niveli në përqindje i humbjeve të tërësishme në rrjet), kjo e shumëzuar me koston e përgjithshme variable të gjenerimit.

Nga sa u tha më lartë ZRRE, ka zhvilluar Bilancin e energjisë termike të NQ Termokos për sezonin 2016/2017, përmes së cilit ka përcaktuar humbjet sasiore të rrjetit **41,813 MWh** – që është shuma e humbjeve sasiore në rrjetin e transportit TC Kosova B – NQ Termokos (4,500 MWh) dhe humbjeve sasiore në rrejtin e shpërndarjes (37,313 MWh). Shprehur në përqindje, niveli i përgjithshëm i humbjeve në rrjet është 16.84% - niveli i humbjeve në rrejtin e transportit: 1.84% dhe niveli i humbjeve në rrejtin e shpërndarjes 15%. Gjithashtu nga Bilanci i energjisë termike është derivuar sasia e prodhimit (gjenerimit) neto dhe blerjeve neto të energjisë termike – në sasi totale 248,753MWh.

Bazuar në vlerat më lartë dhe në koston variable operative (2,185,496 €) llogaritet **Kostoja e humbjeve** në rrjet në vlerën **367,361 €**.

3.6 Përshtatja (Akhustimi)

Përshtatja (axhustimi) shërben për të korigjuar ndryshimet eventuale mes planifikimeve të shqyrtimit tarifor për periudhën (sezonin) 'n' dhe realizimeve që faktikisht kanë ndodhur në atë periudhë (sezonë) dhe ato ndryshime përfshihen (korigjohen) në shqyrtimin e ardhshëm – periudha (sezoni) 'n+1'.

Duke qenë se në këtë sezon zhvillohet procesi i shqyrtimit tarifor pas një periudhe katër vjeçare, pra shqyrtimi tarifor në këtë sezon konsiderohet si shqyrtimi bazë, atëherë për këtë shqyrtim nuk do të aplikohet përshtatja (axhustimi). Normalisht për shqyrtimet e ardhshme përshtatja do të përcaktohet dhe do të jetë komponentë përbërëse e të Hyrave të lejuara.



3.7 Llogaritja e të Hyrave të Lejuara - Përmbledhje

Të Hyrat Maksimale të lejuara janë llogaritur sipas formulës:

$$\text{MAR} = \text{OPM} + \text{DEP} + \text{RTN} + \text{LOS} + \text{ADJ}$$

dhe është e barabartë me **6,319,200 €** siç paraqitet detalisht në tabelën 8.

Tabela 8: Të Hyrat maksimale të lejuara për NQ Termokos sezoni i ngrohjes 2016-2017

Të Hyrat Maksimale të Lejuara NQ TERMOKOS për sezonin 2016-2017		Lejuar nga ZRRE [€]
OC	Kostot Operacionale të Lejuara	3,884,390
DEP	Zhvlerësimi Vjetor	1,501,414
RTN	Kthimi i Lejuar në RAB	566,036
LOS	Kostot e lejuara te humbjeve	367,360
MAR	Të Hyrat Maksimale të Lejuara	6,319,200

Për të qenë në përputhshmëri me strukturën tarifore, që parasheh ndarjen në komponentën për kapacitetin termik (komponenta fikse) dhe në komponentën e sasisë së energjisë termike (komponenta variabile), ndarja e MAR-it bëhet sipas proporcionit: pjesa fikse 15% dhe pjesa variabile 85%. Rrjedhimisht ndarja e MAR-it në pjesën fikse dhe variabile për sezonin e ngrohjes 2016/2017 është si vijon:

Pjesa fikse e të Hyrave Maksimale të Lejuara (MAR_F) **947,880 €; dhe**
Pjesa variabile e të Hyrave të Lejuara (MAR_V) **5,371,320 €.**

